


i



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. <u>01-409/14</u>
Dep. <u>02</u>	Br Prot. <u>31.01.2014</u>
Nr. l faq. <u>02</u>	Data <u>31.01.2014</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>31.01.2014</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>31.01.2014</u>



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11,12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3560/13, për z. Reshit Qafleshi – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Dragashit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për Zyrtarin e lartë, z. Reshit Qafleshi – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Dragashit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Qafleshi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë në të cilin është njoftuar për situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet, dhe për ndryshimet që duhet të bëjë për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Qafleshi, është pajtuar me situatën në të cilën ndodhet dhe ka deklaruar se nuk ka qenë i informuar dhe nuk ka pasur njohuri për këtë situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Qafleshi, ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03- 319/14) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja vullnetare e biznesit privat Ordinanca Shëndetësore “Ola – Med”.

Me këtë ai ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

